



Gjiri i Lalëzit, Durrës
Shqipëri
Komplekset Turistike “Lura 1,2, 3”

Njoftim

Të nderuar banorë,

Shpresojmë që ky njoftim t’ju gjejë mirë ju dhe familjarët tuaj!

Me kenaqësi ju njoftojmë se administrimi dhe mirëmbajtja e ambjenteve të përbashkëta në komplekset turistike “Lura 1”, “Lura 2” dhe “Lura 3” nga data 1 Prill 2020 do jenë nën përgjegjësinë e kompanisë **OnService shpk**. Kalimi i përgjegjësisë nga kompania ndërtuese Lura shpk te kompania OnService shpk ka për referencë kontratën e datës 11/03/2020 me nr.rep. 1207 dhe nr. kol 556.

OnService dhe stafi i saj do impenjohej që shërbimet e mirëmbajtjes dhe administrimit të jenë në nivelin maksimal për një qëndrim sa më të rehatshëm dhe dinjitoz të banorëve të komplekseve turistike. Përveç shërbimeve bazë (pastrimi, mbledhja e mbetjeve, shërbimi i rojeve etj), OnService, në vazhdim do pasurojë komplekset me shërbime dhe facilitete të tjera në përgjigje të nevojave të banorëve.

Duam të thjeshtësojmë sa më shumë komunikim mes banorëve dhe kompanisë së administrimit dhe në njoftimin e dytë do ju prezantojmë me platformën online të komunikimit ku ju do mund të bëni sugjerimet, ankesat, pagesat si dhe të kontaktoni për shërbimet ekstra.

Ju falenderojmë për vëmendjen,

OnService shpk